



Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo




Komuna e Rahovecit/Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Drejtoria për Financë dhe Buxhet

Uprava za Finansije i Budzet

Departament of Finance Budget



Raporti i punës së Drejtorisë për Buxhet dhe Financa për vitin 2018

Ky raport përfshinë të dhënat për periudhën Janar- Dhjetor 2018 nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa, konkretisht nga sektori për Buxhet&Financave dhe Sektori i Tatimit në Pronë. Numri i punëtorëve: 12.

❖ Sektori i Buxhetit dhe Financave

Bazuar në obligimet ligjore të cilat dalin nga Ligji mbi Financat Publike dhe përgjegjësitë, ne si drejtori kemi kryer të gjitha detyrat dhe obligimet që na takojnë.

Në drejtorinë e financave kemi arritur që detyrat të kryhen në afate ligjore dhe çdo e hyr dhe shpenzim të evidentohet dhe të dihet burimi apo shpenzimi.

Gjate kësaj periudhe të punës kemi mbajtur disa takime dhe trajnime të ndryshme me MF, organizata të ndryshme apo donator që kryesisht janë trajtuar qeshjet financiare.

Tek shpenzimet Operative kemi arritur të kursejmë disa shpenzime kryesisht Mallra dhe shërbime në pa e dëmtuar procesin e punës, duke i rritur disa shpenzime-shërbime të cilat në të kaluarën janë paguar nga kapitalet e realisht kanë qenë Mallra Shërbime, siç janë mirëmbajtja e ndërtesave dhe rrugëve, pastrimi i rrugëve gjithashtu kemi arritur që të kemi një inkasim të mirë të të hyrave vetanake .

Në Drejtorin për Buxhet dhe Financa, janë realizuar detyrat kryesore duke respektuar edhe afate ligjore të rregulluara më ligjet që rregullojnë financat publike.

Sipas muajve për gjatë vitit 2018 kemi realizuar këto detyra:

- Përgatitja e Cesh Planit për buxhetin e vitit 2018 - (Janar 2018),
- Përgatitja e raportit financiar për mbylljen e vitit fiskal 2018 për Kuvendin komunal dhe Ministrin e Financave - (Janar - mars 2018),
- Raport për obligimet e bartura nga viti 2017, për obligimet financiare dhe ato kontraktuale,
- Raport, (informatë) për shpenzimet dhe të hyrat për çdo tremujor gjatë vitit 2018,
- Përgatitjet për buxhetin e vitit 2018, qarkorja e parë, KAB-it - qarkorja e dytë, (Maj-Korrik 2018),
- Mungese Rishikimi i buxheti për vitin 2018 në Kuvend.

Komuna e Rahovecit për vitin 2018 ka operuar me një buxhet prej: **13,660,103.00 euro** të përberë nga Grandi qeveritar dhe të hyrat vetanake:

-Grandi i qeveritar	11,824,602.00 euro,
-Të hyrat vetanake	1,650,027.00 euro,
-Huamarrja	185,474.00 euro,
-Gjithsej:	13,660,103.00 euro.

Shpërndarja e buxhetit nëpër kategori ekonomike në vitin 2018 ka qenë:

-Paga e mëditje	7,258,493.00 euro,
-Investime kapitale	4,396,403.00 euro,
-Mallra dhe shërbime	1,563,385.00 euro,
-Shpenzime komunal	250,500.00 euro,
-Subvencione	191,322.00 euro.

Të hyrat e bartura nga viti 2017 në vitin 2018 kanë qenë: 174,221.05 euro.

❖ Shpenzimi i buxhetit në vitin 2018

Shpenzimi i buxheti Janar-Dhjetor 2018						
Nr.	Përshkrimi	Lëndët te certifikuara	Buxheti i aprovuar 2018	Buxheti alokuar	Shpenzimet	Shpenzimi i buxheti të planifikuar %
1	Paga dhe mëditje	0	7,258,493.00	3,617,176.44	3,596,738.33	49.56
2	Mallra dhe Shërbime	1861	1,563,385.00	740,807.35	993,516.60	44.44
3	Shërbime Komunale	810	250,500.00	173,600.00	245,448.41	58.13
4	Subvencione	375	191,322.00	142,192.00	178.112.00	70.35
5	Investime Kapitale	281	4,396,402.00	3,954,618.50	4,390,927.43	66.13
	Totali	1394	13,698,422.00	8,628,394.29	9,226,630.77	54.28

❖ Të hyrat vetanake

➤ Tatimi në prone

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2018 sektori i tatimit në pronë ka realizuar të hyra prej 419,499.69 euro apo +23.38 % të planifikimit vjetor (planifikimi vjetor 340,000.00) euro. Regjistrimet e reja janë 1123 objekte , ose 200.948 m². Verifikimi i objekteve është 2524,ose 390.620 m². Përqindja e realizim të Tatimit në Pronë , në raport me planifikimin është 23.38. %, ndërsa në raport me vitin 2017 është +33.08 %.

Të hyrat në përgjithësi:

Të hyrat e përgjithshme vetanake të realizuara për këtë periudhë janë 1.160,180.40 euro apo 70.31% të planifikimit vjetor (planifikimi vjetor 1,650,027.00).

❖ Përgatitja e buxheti për vitin 2019

Me 15.05.2018 kemi pranuar Qarkoren Buxhetore 2019/1 nga Ministria e Financave e cila paraqet bazën për hartimin e Buxhetit për vitin 2019 dhe vlerësimet për vitet 2020 dhe 2021. Me këtë qarkore buxhetore janë ndarë kufijtë fillestar buxhetor për vitin 2019, ku Komunës se Rahovecit sipas kësaj Qarkoreje ju ka ndarë një buxhet prej **13,658,892.00€**.

Kemi përgatitur dhe kemi dërguar në Kuvend **Kornizën Afatmesme Buxhetore - KAB** për vitet 2019-2021 e cila pritet të aprovohet në Kuvend deri me 30.09.2018.

Projeksionet e shpenzimeve buxhetore për vitin 2019 do ti paraqesim sipas kategorive ekonomike:

- Pagat dhe mëditje.....7,435,669.00€;
- Mallrat dhe Shërbim.....1,514,330.00€;
- Shpenzimet Komunale.....255,500.00€;
- Subvencionet dhe Transferet.....250,001.00€;
- Shpenzimet Kapitale.....4,203,391.00€

TOTAL.....13,658,891.00€

Sfidat për vitin 2018:

- ✓ Realizimi (inkasimi) sa me i madh i të hyrave vetanake gjate vitit 2019,
- ✓ Rritja e përgjegjësisë dhe kontrollit të menaxhimit të financave për vitin 2019,
- ✓ Stafi jo i mjaftueshëm në sektorin e financave dhe tatimin në pronë.

Afrim Limani

Drejtor për Buxhet dhe Financa

